



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 739/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nexhmedin Spahiu, kandidatë i pavarur për Kryetar të Mitrovicës dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Nexhmedin Spahiut, kandidatë i pavarur për Kryetar të Mitrovicës dega në Mitrovicë.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.11.2013, nga Nexhmedin Spahiu kandidatë i pavarur për Kryetar të Mitrovicës dega në Mitrovicë, në të cilën pretendohet se me datë 03.11.2013 në procesin zgjedhor në Mitrovicë është manipuluar me lapsa kimik, me ngjyrë të dukshme dhe të pa dukshme. Më tutje ka shtuar se, para fillimit të procesit të votimit, fletëvotimet janë plotësuar ku shkrimi bëhet i dukshëm pas një kohe, ndërsa lapsi kimik i cili gjendet në kabinë pasi që votuesi ka votuar ngjyra është zhdukur. Për më tepër ka shtuar se, i gjithë procesi i votimit është i fabrikuar.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se *“Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj”*. Në rastin konkret ankesa është parashtuar nga kandidati për anëtarë të

kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 739/2013 më datën 08.11.2013



**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**

**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.